

Prishtinë, 15 mars 2007
Kodi i ZRRE-së: D_39_2007

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Ka pranuar aplikacionin nga KEK Sh.A., për miratimin e tarifave të reja me pakicë të propozuara, që do të zbatohen nga data 1 prill 2007;

dhe duke marrë parasysh:

1. Detyrat e veta, sipas neneve 45 dhe 48 të Ligjit Nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë” dhe veçanërisht kërkesat sipas nenit 46.2 që:
 - d) *çmimet duhet të marrin parasysh brengat në lidhje me mjedisin dhe me mbrojtjen e konsumatorëve;*
 - e) *çmimet për grupet individuale të konsumatorëve duhet të jenë në përputhje me kostot e dërgesës së energjisë elektrike, ngrohjes dhe gazit natyror, për ata konsumatorë;*
 - f) *ndër-subvencionet ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve nuk do të lejohen;*
2. Dispozitat e Rregullës mbi Parimet e Kalkulimit të Tarifave në sektorin e energjisë elektrike (“Rregulla mbi çmimet”) dhe Metodologjia e Tarifave;

Vendimin e Bordit të ZRRE-së i datës 21 Dhjetor 2006 (D_29_2006) që përcakton të hyrat e lejuara, e që do të mblidhen nga KEK Sh.A, nëpërmjet të tarifave të rregulluara me pakicë për vitin 2007, në vlerë prej 141,899,000 €.

ka:

1. Konfirmuar pajtimin ndërmjet tarifave të reja me pakicë të propozuara, dhe të hyrave të lejuara, të miratuara më herët nga bordi i ZRRE-së, ashtu që tarifatat e reja me pakicë do të zbatohen ndërmjet 1 prillit dhe 31 dhjetorit 2007.
2. Pranuar, ashtu si është përshkruar në historikun e bashkëngjitur dhe të publikuar me këtë Vendim, argumentet e dhëna, nga KEK Sh.A për miratimin e një tarife të vetme të energjisë për konsumatorët e amvisërisë për vitin 2007, por duke theksuar se ky përjashtim (derogim) është i përkohshëm dhe nuk e detyron ZRRE-në, që të marrë vendim për të miratuar një strukturë të tillë të tarifave për vitet e ardhshme.
3. Refuzuar propozimin e bërë nga KEK-Sh.A për eliminimin e dy blloqeve ekzistuese të konsumit (prej <800kWh/muaj dhe 800kWh/muaj), të zbatueshme për tarifatat e energjisë që iu ngarkohen konsumatorëve të amvisërisë për shkak të shqetësimeve në ndikimin rezultues në përballimin e furnizimit me energji elektrike, për konsumatorët me të ardhura të ulëta,
4. Përkatesisht siç është përshkruar në arsyetimin e bashkëngjitur dhe të publikuar në këtë Vendim, ka bërë modifikimin e tarifave të propozuara me pakicë, duke futur një strukturë konsumi prej tre blloqesh, të zbatueshme për tarifatat e energjisë që u ngarkohen

konsumatorëve shtëpiak, me nivelin e blloqeve të përcaktuar në bazë të vlerësimit të ZRrE-së lidhur me nevojat minimale të konsumit për konsumatorët me të ardhura të ulëta.

Dhe, në Seancën e Bordit të datës 15 mars 2007, ka vendosur të:

1. Aprovojë tarifave me pakicë, të bashkëngjitura, për zbatim nga KEK Sh.A prej datës 1 prill 2007, ashtu siç janë analizuar, shqyrtuar dhe përcaktuar nga Bordi i ZRRE-së.
2. Aprovojë, vetëm për qëllim të kësaj kërkesë, një përjashtim në nenin 8.4 të Rregullës së Çmimeve, duke i lejuar KEK-ut Sh.A që të aplikojë për miratim të tarifave të reja me pakicë, të cilat do të hyjnë në fuqi nga data 1 janar 2008, dhe që nga atëherë në çdo 12 muaj.
3. Ky Vendim duhet të publikohet nga KEK Sh.A. brenda 5 ditëve të punës, pas njoftimit të ZRrE-së dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të saj, së paku në një prej gazetave ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë,
4. Ky Vendim është nxjerrë në gjuhën: shqipe, serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbisundojë versioni në gjuhën angleze.
5. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi më 20 mars 2007.

Bordi i ZRrE-së:

Ali Hamiti

Kryesues

Merita Kostari

Anëtare

Theranda Beqiri

Anëtare

Naim Bejtullahu

Anëtar

Nysret Avdiu

Anëtar

Bashkëngjitja: Tarifat e rregulluara me pakicë, të aprovuara për KEK-un

Aplikacioni i KEK Sh.A për tarifa me pakicë (me blloqe)

Modifikuar nga ZRrE-ja më 8 mars 2007

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementet tarifore	Njësia	Koha gjatë ditës (a)	Kërkesa e KEK Sh.A	
					Sezona e lartë	Sezona e ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		519	519
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.03	1.78
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.5	1.47
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh			
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		30	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		540	540
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.3	2.73
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.33	2.47
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.04	0.04
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		466	466
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7.07	3.15
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.81	2.87
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.32	0.32
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët me shpenzim të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		29	
		Fuqia e angazhuar	€/kW			
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	9.83	5.4
			€/kWh	Tarifa e ulët	6.15	5.08
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		1.53	1.53
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34	
		Fuqia e angazhuar	€/kW			
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifa e vetme	9.73	6.23
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	11.05	6.35
			€/kWh	Tarifa e ulët	7.14	6.01
5	0.4kV matësi 2-tarifor (2-vlerësh) shtëpiak (c)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		20	
		Energjia aktive (P), për konsum:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	3.47	2.49
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.47	2.49
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	4.76	3.42
			€/kWh	Tarifa e ulët	4.76	3.42
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	8.43	6.06
€/kWh	Tarifa e ulët		8.43	6.06		
6	0.4kV matësi 1-tarifor (1-vlerësh) shtëpiak (c)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		20	
		Energjia aktive (P), për konsum:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e vetme	3.47	2.49
			€/kWh	Tarifa e vetme	4.76	3.42
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë) prej të cilit: (d)	€/kWh	Tarifa e vetme	8.43	6.06
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar <400kWh/muaj	€/konsumator/muaj		23	
		Konsumi i vlerësuar 400-800kWh/muaj	€/konsumator/muaj		42	
		Konsumi i vlerësuar >800kWh/muaj	€/konsumator/muaj		71	
8	Ndriqimi publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34	
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifa e vetme	7.82	7.82